

BASHKIA E TIRANËS

30.12.2014

Nr. Prot. 12976/9

KONTRATE SIPËRMARRJE

OBJEKTI

**“Rikonstrukcion i plotë dhe shtesë ambientesh në shkollën e
mesme “Qemal Stafa” (Njësia nr.10)”**

2014

KONTRATË SPËRMARRJE
“Rikonstruksion i plotë dhe shtesë ambientesh në shkollën e mesme “Qemal Stafa” (Njësia nr.10)”

Lidhur sot më datë _____ 2014 në bazë të nenit 850 dhe në vazhdim të Kodit Civil, midis:

Bashkisë së Tiranës, e përfaqësuar nga **Z. Etion Kapedani**, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor (i autorizuar me anë të Autorizimit nr. 68, datë 05.01.2012), me adresë: Shëtitorja “Dëshmorët e Kombit”, nr. 2, 1001, Tiranë, që më poshtë do të quhet **“Autoriteti Kontraktor”**;
dhe

Bashkimit të shoqërive **“Aurora Konstruksion” shpk & “Everest” sh.p.k, & “BE-IS” shpk** rregjistruar respektivisht si më poshtë shënuar:

Shoqëria **“Aurora Konstruksion”shpk** e regjistruar me Vendim Gjykate Nr. 23427, datë 20.03.2000, me licensë profesionale të shoqërisë **NZ. 3558/9**, me vlefshmëri deri me date 18.08.2019, lëshuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, me seli të shoqërisë: **Bulevardi “Zogu i Pare”, Pallati prane Fakultetit të Shkencave, Tiranë**, me Nipt **K020170031** e përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor i shoqërisë **Z. Astrit Haxhiu**.

Shoqëria **“Everest” sh.p.k.** regjistruar me Vendim Gjykate Nr.17484 datë 28.07.1997, me licensë profesionale të shoqërisë **NZ.2657/11**, me vlefshmëri deri më datë 21.07.2019, lëshuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, me seli të shoqërisë: **Rruga: Fabrika ne rrugën Nacionale, prane Njës se Betonit, Kamez, Tiranë**, me Nipt **J78311921L** e përfaqësuar nga Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë **Z. Sokol Çupi**, si dhe,

Shoqëria **“BE - IS” sh.p.k.** regjistruar me Vendim Gjykate Nr.36820 datë 22.12.2006, me licensë profesionale të shoqërisë **NZ. 5430/8**, me vlefshmëri pa afat kohor, lëshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastruktures, me seli të shoqërisë: **Lagjia nr. 5, pallati nr. 23, Hyrja nr. 1, Ap. Nr. 10, kati i IV-t, Kukës**, me Nipt **K71412003A** e përfaqësuar nga Përfaqësuesi Ligjor i shoqërisë **Z. Hamz Islamaj**, i mëposhtëquajtur **“Kontraktor”**.

Shoqëritë **“Aurora Konstruksion”shpk**, **“Everest” sh.p.k si dhe “BE-IS” shpk**, me anë të Kontratës për Bashkëpunimin e përkohshëm të shoqërive lidhur më datë 12.11.2014, me Nr. 7411 Rep, Nr. 3158 Kol, Tiranë, kanë rënë dakort të bëjnë bashkimin e përkohshëm të shoqërive për realizimin e objektit **“Rikonstruksion i plotë dhe shtesë ambientesh në shkollën e mesme “Qemal Stafa” (Njësia nr.10)”** ku shoqëria **“Aurora Konstruksion” shpk**. do të realizojë 35 % të punimeve, shoqëria **“Everest” sh.p.k** do të kryejë 35 % të punimeve dhe shoqëria **“BE-IS” shpk** do të kryejë 30 % te punimeve. Me anë të Prokurës së Posacme të datës 12.11.2014, me Nr. 7412 Rep, Nr. 3159 Kol, Tiranë shoqëritë **“Be - Is” sh.p.k** dhe **“Everest” shpk** autorizojne shoqërinë **“Aurora Konstruksion” shpk** me Përfaqësues Ligjor **Z. Astrit Haxhiu** të jetë përfaqësues i bashkimit të përkohshëm të shoqërive në realizimin e objektit të Kontratës, i mëposhtëquajtur **“Kontraktor”**;

Neni 1. Objekti i Kontratës

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate është sipërmarrja me objekt: **“Rikonstrukcion i plotë dhe shtesë ambientesh në shkollën e mesme “Qemal Stafa” (Njësia nr.10)”** në përputhje të plotë me projekt - zbatimin e objektit.

Neni 2. Vlera e Kontratës

- 2.1 Kontrata lidhet me një vlerë totale **152.297.454** (njëqind e pesëdhjetë e dy milion e dyqind e nentëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e pesëdhjetë e kater) lekë me tvsh.
- 2.2 Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruara nga kontraktori në ofertën e tij.

Neni 3. Afati i realizimit të punimeve

- 3.1 Afati maksimal i përfundimit të punimeve është 10 (dhjetë) muaj kalendarik nga data e lidhjes së kontratës.

Neni 4. Gjuha e Kontratës

- 4.1 Gjuha në të cilën përpilohet kontrata është Gjuha Shqipe.

Neni 5. Përkuftizime

- 5.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes të dhëna në projekt të cilat janë orientuese, plotësuar me çmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelisa në dore.
- 5.2 “Preventiv për njësi” do të thotë volumet e punes të dhëna në projekt shogëruar me çmimet për njësi të pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime në majë.
- 5.3 “Afati i realizimit të punimeve” do të thotë data që Punët duhet të përfundojnë siç është shprehur në Grafikonin për realizimin Punimeve, e vërtetuar nga entë prokurues.
- 5.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjiftet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 5.5 “Çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 5.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 5.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e papërfunduar në përputhje me kontratën.
- 5.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.

- 5.9 “Data e fillimit” eshte perفشire ne të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 5.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 5.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 5.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 5.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 5.14 “Drejtuues projekti” do të thotë Mbikqyrësi i Punimeve i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 5.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe që kontraktion punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.
- 5.16 “Drejtor Teknik” është personi i caktuar nga Kontraktori në ofertën e tij, i cili përmbush kualifikimet e përcaktuara nga Autoriteti Kontaktues si dhe i aprovuar prej tij, i cili është personi përgjegjës nga ana e Kontraktorit për zbatimin e punimeve ne Kantier deri në përfundimin e tyre, i pranishëm në kantierin e ndertimit dhe është përfaqësuesi i Kontraktuesit ne te gjitha kontaktet me perfaqësuesit e Autoritetit Kontraktor.
- 5.17 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 5.18 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojne informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 5.19 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 5.20 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 5.21 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 5.22 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.

- 5.23 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.
- 5.24 “Formulari i deklarimit të ofertës” - është dokumenti i plotësuar që kontraktori ka dorëzuar në datën e hapjes së tenderit dhe është pranuar nga Enti Prokurues.
- 5.25 “Data e përfundimit të kontratës” është data e vërtetuar nga Enti Prokurues.
- 5.26 “Ditët” janë ditë kalendarike dhe “muajt” janë muaj kalendarik.
- 5.27 “Ndryshimi” është një udhëzim që jep Autoriteti Kontraktori paparahshikuar në dokumentat fillestare dhe jepet gjithmonë me shkrim.
- 5.28 “Raste të kompensuara” janë ato që përcaktohen në pikën 34.
- 5.29 “Periudha e garancisë” së difekteve është 24 (njëzetekatër) muaj.
- 5.30 “Skica (vizatimet)” përfshijnë projektet dhe të dhëna të tjera të paraqitura ose të miratuara nga Enti Prokurues për përmbushjen e Kontratës.
- 5.31 “Specifikimet” janë karakteristikat e punimeve të përfshira në projektet e zbatimit në dokumentat standarte të tenderit dhe çdo modifikim ose shtesë e bërë dhe e miratuar me shkrim nga Investitori.
- 5.32 “Punimet” janë punimet që duhet të kryhen nga Kontraktori në përputhje me kontratën, projektin dhe ndryshimet e tij.

Neni 6. Dokumentat e tenderit

- 6.1 Të gjitha dokumentat e tenderit të dhëna nga Autoriteti Kontraktor dhe të marra në formën e ofertës nga kontraktori janë pjesë përbërëse dhe integrale e kësaj kontrate.

Neni 7. Prona Intelektuale

- 7.1 Të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do të përkasin Autoritetit Kontraktor i cili i përdor ato sipas gjyqimit të tij.
- 7.2 Kontraktori pas përfundimit të kontratës duhet ti dorëzojë Autoritetit kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, skicimet, specifikimet planet llogarifjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose të pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës, Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave po nuk mund ti përdorë për qëllime që kanë lidhje me kontratën pa lejen me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 7.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

- 7.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkellje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktori që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 8. Mbikqyrësi i Punimeve

- 8.1 Bashkia e Tiranës me të drejtën e Investitorit si Autoritet Kontraktor, në mbështetje të dispozitave ligjore për drejtimin dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit dhe konkretisht Udhëzimit Nr 1, datë 16.06.2011 për “Disa ndryshime në udhëzimin Nr 3 datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave, “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit, të ndryshuar”, nëpërmjet procedurës së prokurimit ne mbështetje të ligjit nr 9643 dt 20.11.2006 për “Prokurimin Publik” (të ndryshuar) përzgjedhi bashkimin e shoqerive “Mega Studio” shpk + “Klodioda” shpk me licencë “Për mbikqyrje dhe kolaudim punimesh zbatimi” respektivisht “Mega – Studio” shpk me Nr MK. 1705/2, dhe “Klodioda” shpk me nr. MK 0773/7, për mbikqyrjen e punimeve në objekt;

Detyrat e mbikqyrëseve të punimeve burojnë nga aktet ligjore dhe n/ligjore në fuqi dhe detajohen në kontratën e shërbimit që do të lidhet me këta të fundit.

- 8.2 Në rast se mbikqyrësi do të ndryshohet Autoriteti Kontraktor njofton menjëherë Kontraktorin.
- 8.3 Mbikqyrësi i Punimeve do të vendosë për çështjet e kontratës midis Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor.
- 8.4 Mbikqyrësi i Punimeve mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij te tjetrit përveç zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe konflikteve. Mbikqyrësi i Punimeve duhet të njoftojë me shkrim Kontraktorin për delegimet e bëra apo të deleguara.
- 8.5 Mbikqyrësi i punimeve duhet të kontrollojë Punimet e egzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktori, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraget komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.

- 8.6 Me përyashtrim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga mbikqyrësi i punimeve.

Neni 9. Personeli i Kontraktorit

- 9.1 Kontraktori është i detyruar të punësojë në kantier për kryerjen e funksioneve të parashikuara në programin e miratuar nga Mbikqyrësi i Punimeve vetëm personelin inxhinjierik të deklaruar në ofertë.
- 9.2 Mbikqyrësi i Punimeve do ti propozojë Autoritetit Kontraktor për të zëvendësuar personelin kryesor vetëm nëqoftëse kualifikimet dhe aftësitë e tyre të nevojshme janë baraz ose më të larta se ato të personelit të përcaktuar në ofertën e Kontraktor.

9.3 Në qoftë se Mblikqyrësi i Punimeve i kërkon Kontraktorit që të largojë një person, i cili është anëtar i personelit ose i fuqisë punëtoare të Kontraktorit, duke theksuar arsyet, Kontraktori do të marrë masa për të siguruar që personi në fjalë të largohet nga kantieri i punimeve brenda 72 orëve dhe të mos ketë më lidhje me punën e përfshirë në kontratë.

9.4 Kontraktori është i detyruar të caktojë Drejtorin Teknik. Drejtori Teknik është personi që Kontraktori ka përcaktuar në ofertën e tij. Drejtuesin Teknik të Punimeve të objektit do të jetë **Zj. Irimi Gjilkondi** të përfshirë në licensën profesionale të shoqërisë “Aurora Konstruktion” me nr. **NZ. 3558/9** lëshuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Detyrat e Drejtorit Teknik të Punimeve janë si më poshtë:

- a) Zbatimin e objektit konform projektit dhe kushteve teknike të zbatimit
- b) Te jete i pranishem gjate gjithë kohes se zbatimit te punimeve ne kantier;
- c) Te jete i pranishem dhe te përfaqësojë Kontraktorin në të gjitha kontaktet, takimet zyrtare apo mbledhjet që Autoriteti Kontraktor zhvillon me Kontraktorin dhe Drejtorin e Projektit në zgjidhjen e diskutimin e çështjeve teknike e profesionale që lindin gjate zbatimit te punimeve;
- d) Është përgjegjës per dokumentacionin teknik që është i detyrueshëm të mbahet në objekt;
- e) Mban Korrespondencën zyrtare me Mblkqyrësin e Punimeve;
- f) Është përgjegjës për ecurinë e zbatimit të punimeve konform plan organizimit dhe grafikut të punimeve;
- g) Është i pranishëm në të gjitha fazat e realizimit të objektit: zbatimin e punimeve, dorëzimin dhe kolaudimin e objektit.

9.5 Në rast se ndryshohet Drejtuesi Teknik, Kontraktori duhet detyrimisht të lajmërojë Mblkqyrësin e Punimeve i cili vë në djeni Autoritein Kontraktor.

9.6 Drejtuesi teknik ne këtë rast duhet të ketë të gjitha kualifikimet e kërkuara në dokumentat e tenderit për Drejtuesin teknik. Autoriteti Kontraktor mund të kundërshtojë emërimin e Drejtuesit Teknik nëse vlereson se ai nuk permbush kualifikimet e percaktuara ne Dokumentat e tenderit. Në këtë rast Kontraktori cakton një Drejtues teknik tjetër dhe detyrimisht lajmëron Mblkqyrësin e Punimeve i cili vë në djeni Autoritein Kontraktor.

Neni 10. Detyrimet e Kontraktorit

10.1 Kontraktori do të kryejë punimet në përputhje me projektet e ndryshimet e miratuara e të dhëna nga Autoriteti Kontraktor dhe në përputhje me K.T. të zbatimit të RSH, specififikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

10.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specififikimeve teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor me përjashtim të rasteve kur gabimi është aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta reklamonte tek Autoriteti Kontraktor.

10.3 Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

10.4 Drejtuesi Teknik i Punimeve në kantier, është i detyruar të mbajë ditarin e objektit, ku të përshihen të gjitha punimet e kryera dhe urdhërat e dhëna për projektin. Ky ditar në

- çdo kohë do ti vihet në dispozicion Mbikqyrësit të punimeve, grupit të kolaudimit dhe Investitorit.
- 10.5 Kontraktori do të kryejë punime me nënsipërmarrje vetëm nëse Autoriteti Kontraktor e ka lejuar këtë në dokumentat e tenderit vetëm pasi të ketë marrë miratimin e Investitorit.
- 10.6 Nënkontraktori do të jetë subjekti i deklaruar si nënkontraktor në ofertën e Kontraktorit dhe do të kryejë vetëm punimet e deklaruar në ofertë dhe jo më shumë se 40% të vlerës së Kontratës.
- 10.7 Marrëdhëniet e n/sipërmarrjes do rregullohen nëpërmjet një marrëveshjeje e cila përcakton qartë nënsipërmarrjen dhe që në çdo rast është e detyruar të respektojë të gjitha detyrimet e kontratës së sipërmarrjes. Përgjegjës ndaj Autoritetit Kontraktor mbetet gjithmone Kontraktori kryesor i punimeve.
- 10.8 Kontraktori mund ti japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktori të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë kontraktori duhet të përshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtton ruajtjen e konfidencës sic thuhet në nenin Informacioni Konfidencial.
- 10.9 Kontraktori ka për detyrë të ruaj projektin dhe të mos e përdorë atë në objekte të tjera jashtë këtij tenderi. Gjithashtu të mos japë asnjë informacion (botim artikujsh apo fotografish) mbi ecurinë e punimeve për lejen e Investitorit.
- 10.10 Kontraktori është i detyruar të marrë të gjitha masat për kufizimin e ndoqjes së ambientit duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion.
- 10.11 Kontraktori është i detyruar të rrethojë kantierin e punimeve të ndërtimit në datën e fillimit dhe hyrjes në kanjer sipas standarteve të përcaktuara.
- 10.12 Kontraktori është i detyruar të lagë me ujë zonën e kantierit të punimeve të ndërtimit me qëllim eliminimin e ndoqjes së mjedisit si rrjedhim i kryerjes së punimeve.
- 10.13 Kontraktori është i detyruar të pajisë me uniformë pune të gjithë personelin punëtor. Uniformat e punës duhet të kenë të evidentuar emrin e kontraktorit si dhe të jenë të pajisura me shirita fosforike për tu dalluar natën.
- 10.14 Kontraktori është i detyruar të përdori mjetet e sinjalistikës rrugore për punime në rrugë me qëllim disiplinimin e trafikut të mjeteve dhe kalimtarëve në objektin e ndërtimit. Këto mjete duhet të vendosen në mënyrë të dukshme për të gjithë.
- 10.15 Kontraktori është i detyruar të vendosë në kantier të gjitha makineritë dhe mjetet e paraqitura në ofertë, mbi bazën e të cilës ai është shpallur fitues. Mjetet e garkullimit duhet të jenë të pajisura me lejet përkatëse.
- 10.16 Në rast të mos respektimit të dispozitave të parashikuara në pikën 10.8 Mbikqyrësi i punimeve i bën njoftim me shkrim Kontraktorit për respektimin e detyrimeve të shprehura

më lart dhe korrigjimin e tyre. Në rast se Kontraktori nuk merr masa brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit atëhere Mbikqyrësi i punimeve i propozon Investitorit, Autoritetit Kontraktor aplikimin e një penaltieti në masën nga 50.000 lekë deri 200.000 lekë, penaltiet i cili do të mbahet nga situacioni pasardhës që do të paraqiten për likuidim.

10.17 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor sic kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve

10.18 Te gjitha te drejtat e prones intelektuale te siguruar nga kontraktori gjate zbatimit te kontrates do ti perkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund ti perdore ato sipas gjykimit te tij.

10.19 Kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specififikimet, planet, statistikat, llogaritet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrimin nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 11: Kontrolli i Cilësisë

11.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

11.2 Sapo kontrata të filloje efektet e saj teknike dhe financiare, kontraktori duhet t'i paragesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteve në zbatimin e kontratës.

11.3 Mbikqyrësi i punimeve duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

11.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

Neni 12. Disponimi i Kantierit

12.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrien e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 13. Ngritja e Kantierit

13.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për skicimin e Ngritjes se Kantierit.

13.2 Kontraktori duhet të paragesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek Mbikqyrësi i Punimeve për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 14. Zbulimet

14.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për te vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 15. Paturia

15.1 Të gjitha punimet e kryera dhe materialet e montuara për realizimin e objektit do të konsiderohen si pronë e Investitorit në rast prishje kontrate.

Neni 16. Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

16.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

16.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 17. Ekzekutimi i Punimeve

17.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë me nënshkrimin e saj, kohë në të cilën do të fillojnë dhe efektet teknike -financiare të zbatimit të kësaj kontrate dhe duhet ti mbarojë Punët brenda afatit të përcaktuar në Nenin 3 të kësaj kontrate.

Neni 18. Sigurimi teknik dhe mjedisor

18.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteve në kantier.

18.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të redukttojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 19 Testimet dhe Inspektimet

19.1 Kontraktori është i detyruar që me shpenzimet e veta të kryejë provat laboratorike të materialeve që do të përdoren në objekt si dhe provat e kampioneve të marra nga objekti në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Mbikqyrësi i Punimeve dhe nga normativat në fuqi.

19.2 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kostoja e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga Kontraktori brenda kushteve të çmimit të kontratës.

19.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë Kontraktorit të bëjë testimet ose inspektimet shtesë të pa parashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se ndërtimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës.

19.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo punim ndërtimi që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

19.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i punimeve të ndërtimit nuk do ta lirojë Kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 20 Garancitë

20.1 Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me Punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me pënjashim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

20.2 Me pënjashim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

20.3 Materialet e përdorura duhet të përmbushin standartet shtetërore në fuqi.

Neni 21 Sigurimi Teknik

21.1 Kontraktori është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë në kantierin e ndërtimit, duke zbatuar masat korrigjuese dhe rregullat e sigurimit teknik për gjithë personelin sikurse përcaktohet në legjislacionin Shqiptar.

Neni 22 Rreziget e Kontraktorit dhe Forca Madhore

22.1 Kontraktori ka për detyrë të përballojë të gjitha shpenzimet që mund të dalin nga data e fillimit të punimeve e deri në fund të periudhës së garancisë për difektet që mund të shfaqen në objekt sipas të dhënave të kontratës. Kontraktori deri në përfundim të punimeve do të përballojë rreziget për shkak të dëmtimeve të personelit, vdekjes dhe humbjes ose dëmtimit të pasurisë (përfshirë pa kufizime punimet, materialet dhe paisjet, kantierin e ndërtimit si dhe objektin e ndërtimit).

22.2 Kontraktori nuk do të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës jo për fajin e tij, dëmeve të likuiduara ose ndërprerjen për mosplohtësim në se dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

- 22.3 Për qëllimet e këtij neni “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Investitorit gofë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftra ose revolucionet, përmblyrja, tërmeti, epidemitë, shtërngjime të karantinës dhe embargo tranziti.
- 22.4 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktori duhet të njoftojë menjehere Investitorin. Me përfundim kur Autoriteti Kontraktor jep direktiva të ndryshme, Kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha njetet e arsyeshme për zbatimin e kontratës deri në masën e mos pengesës nga Forca Madhore.

Neni 23: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

- 23.1 Me përfundim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.
- 23.2 Me përfundim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit të Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.
- 23.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbrisë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shumata e pagesës ndaj Kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japë kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbrirjes.
- 23.4 Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.
- 23.5 Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Në rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

Neni 24. Sigurimi

- 24.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin me vlerë totale 126.914.545 (njëqind e njezete e gjashtë milion e nentëqind e katërmbedhjetë mijë e pesëqind e dyzete e pese) lekë me emra të përbashkët të investitorit dhe Kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në datën e realizimit të plote të ndërtimit, për humbje ose dëmtim të Ndërtimit, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.
- 24.2 Rregulloret për certifikatat e sigurancionit do të dorëzohen Mbikqyrësit të Punimeve për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. I gjithë ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmtim të shkakuar. Nëse Kontraktori dështon të sigurojë certifikatat e kërkuara të sigurancionit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të vendosi të zgjasë

peruidhën e paraqitjes të certifikatave të siguracionit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbrosi koston e tij nga pagesa që i jep Kontraktorit.

24.3 Ndryshime në kushtet dhe afatet e siguracionit nuk duhet të bëhen pa aprovimin me shkrim të Investitorit.

Neni 25. Preventivi

25.1 Kontrata përfshin një preventiv për njësi. Preventivi do të përfshijë të gjitha zërat e punimeve me çmimet përkatëse të parashikuara në ofertë.

25.2 Preventivi do të përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës. Kontraktori paguhet me sasinë e punës së kryer sipas projektit, bazuar për çdo zë pune të preventivit me çmimin në njësi për secilin zë punimesh.

25.3 Për zërat e reja, të paparashikuara në preventiv përveç dokumentacionit përkatës paraqitet edhe analiza teknike për çdo zë të ri pune e cila i paraqitet Mbikqyrësit të Punimeve nga Kontraktori. Mbikqyrësi i Punimeve pasi bën kontrollin e analizës teknike ia con për miratim Autoritetit Kontraktor.

25.4 Nën/zërat e punimeve për të cilat nuk është vënë çmim për njësi në ofertën e paraqitur, do të konsiderohen si të mbuluara nga vlerat e tjera të përfshira në kontratë.

Neni 26 Negociatat dhe Amendamentet

26.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që kanë përbërë bazën e përzgjedhjes së Kontraktorit.

26.2 Asnjë amendament ose variation tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë dhe duke u referuar shprehimisht kontratës. Çdo shtesë ose ndryshim Amendamenti do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se nënshkruhet nga të dyja palët ose nga persona të autorizuar prej tyre.

26.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, në të cilën të specifikohet data dhe të nënshkruhen nga pala ose nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

Neni 27 Ndryshimi i Porosisë

27.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegociimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përfashitim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe e nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori.

27.2 Ndertime shtesë mund të porosisen vetëm në rehana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit original të kontratës.

- 27.3 Autoriteti Kontraktor mund që në çdo kohë të porosisë Kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës sa më poshtë vijon:
- Korrigjime në skicimin, vizatimin ose specifkimet e Ndertimeve;
 - Korrigjime në materiale;
 - Korrigjime në sasi.

27.4 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në skedimin e dorëzimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të trupëzojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pagtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.

27.5 Ndryshimi i porosisë nuk do të jete i vlefshem ne se nuk formalizohet sipas kërkesave te Nenit 28.2 te kesaj kontrate.

27.6 Çdo ndryshim i urdhëruar nga Investitori, do të jetë objekt i një proces - verbali (urdhëri) me shkrim i firmosur nga Investitori. Këto urdhëra do të hartohen në bazë të një propozimi teknik nga ana e Investitorit dhe në baze të llogarive përkatëse të bëra nga Kontraktori dhe Mblikqyrësi i Punimeve, mbështetur në çmimin njësi për çdo zë pune shprehur në preventiv.

27.7 Çdo ndryshim i cili sjell rritjen e vlerës së kontratës duhet të dokumentohet gjatë zbatimit të punimeve dhe pasi përgatitet dokumentacioni përkatës si preventivi shtesë, vizatime etj., i propozohen zyrtarisht entit që delegon fondin që të miratojë shtesën e vlerës së plotë si dhe për të gjetur burimet e financimit.

27.8 Nëse volumet përfundimtare të punimeve të kryera, ndyshojnë nga volumet në Preventivi dhe vlera e tyre është brenda preventivit të objektit dhe fondit rezervë të parashikuar në preventiv, Autoriteti Kontraktor ngarkon Mblikqyrësin e punimeve për të sistemuar volumet dhe për të dokumentuar ndryshimet e mundëshme dhe mandej i miraton ato .

Neni 28 Programi

28.1 Brenda 5 ditëve nga fillimi i efekteve teknike dhe financiare të kontratës kontraktori do ti parages për miratim Mblikqyrësit të Punimeve një program, në të cilin tregohet mënyra e kryerjes së punimeve dhe grafiku kohor. Kontraktori do të realizojë programin sipas grafikut të parashikuar. Kontraktori ka të drejtë t'i propozojë Mblikqyrësit të punimeve ndryshime në grafikun e punimeve duke i motivuar ato. Në këtë rast Mblikqyrësi i Punimeve miraton ndryshime në program vetëm nëse ky ndryshim nuk do të ndikonte në afatin e realizimit te punimeve. Mblikqyrësi i punimeve mund të kërkojë rishikimin e grafikut të punimeve për të përshpejtuar realizimin e tyre gjatë realizimit të punimeve.

28.2 Në rast se mund ose lind nevoja e dorëzimit të pjesës së punimeve këto parashikohen në grafikun e punimeve ose në ndryshimet e propozuara dhe të miratuara nga investitori.

20.1 Kontraktori duhet të paralajmëtojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 29 Korrigjimi i Difekteve

29.1 Sa herë që gjatë periudhës së zhvillimit të punimeve, nga Autoriteti Kontraktor konstatohet një difekt Kontraktori është i detyruar ta korrigjojë atë brenda afatit që i lihet me shkrim por jo më vonë se 15 ditë.

29.2 Gjatë periudhës së garancisë së punimeve Autoriteti Kontraktor do të njoftojë Kontraktorin lidhur me çdo difekt para mbarimit të kësaj periudhe. Për eliminimin e difekteve lihet një afat i cili saktësohet sipas çdo rasti konkret por jo më shumë se 15 ditë.

29.3 Periudha e garancisë për difektet është afati 24 muaj. Me përfundimin e kësaj periudhe Kontraktori paraqit kërkesën e kthimit të vlerës së garancisë së punimeve e cila i është mbajtur nga Investitori. Ky i fundit, brenda 10 ditëve organizon vizitën në terren ku kontrollohen realizimet e detyrave të lëna nga korrigjimi i difekteve të lindura gjatë periudhës së garancisë së punimeve. Në se janë kryer gjithë korrigjimet e difekteve atëherë hartohet akti përkatës i marrjes në dorëzim të objektit dhe që shënon përfundimin e detyrimeve reciproke të kontratës së sipërmarrjes dhe asaj të mbikqyrjes së punimeve.

29.4 Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përthën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospëmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

Neni 30. Difektet e Pakorrigjuara

30.1 Në qoftë se Kontraktori nuk korrigjon difektet e konstatuara në periudhën e garancisë së difekteve, brenda afatit të përcaktuar, Autoriteti Kontraktor do të vlerësojë koston e korrigjimit të difektit, dhe Kontraktori do të paguaj këtë shumë, së bashku me një gjorbë të vecantë e cila do të jetë 0.04% të vlerës së kontraktuar për çdo ditë vonesë. Autoriteti Kontraktor do ta mbajë këtë shumë duke e zbritur nga garancia e punimeve e cila është mbajtur progresivisht në situacione.

30.2 Në se me përfundimin e periudhës së garancisë Kontraktori nuk ka korrigjuar difektet e konstatuara Autoriteti Kontraktori zbrit nga garancia deri ne konfiskimin e krejt garancisë së punimeve.

Neni 31 Situacionet

31.1 Kontraktori do t'i paragësë Mbikqyrësit të Punimeve brenda 5 ditëve të para të çdo muaji situacionet mujore progresive për punimet e kryera, duke zbritur pagesat e situacioneve të mëparëshme, garancinë e difekteve, paradhënien etj., të kësaj natyre, sikurse përcaktohet në këtë kontratë.

31.2 Mbikqyrësi i Punimeve do të kontrollojë punën e kryer nga Kontraktori dhe do të vërtetojë shumën që duhet ti paguhet Kontraktorit brenda 10 ditëve nga paraqitja e situacionit. Gjatë kontrollit Mbikqyrësi përcakton vlerën e punimeve të kryera.

31.3 Vlera e punës së kryer do të përfshijë vlerën e volumeve të zërave të punimeve të përfunduara dhe të shprehura në preventiv, vlerën e ndryshimeve dhe të rasteve të

kompensuara pa prekur fondin rezervë i cili do financohet në situacionin përfundimtar në se ka dokumenta që argumentojnë përdorimin e tij.

Neni 32 Kushnet e pagesës

- 32.1 Pagesat për çdo situacion punimesh do të kryhen nga Autoriteti Kontraktor brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së situacionit nga Mbikqyrësi i Punimeve tek Autoriteti Kontraktor. Pagesat e situacioneve do të kryhen në numrin e llogarisë bankare të Kontraktorit: IBAN: AL 4320511038107174 CLPRCLALLA
- 32.2 Paga e situacioneve do të kryhet sipas financimit të parashikuar në pikën 2 të kësaj kontrate.
- 32.3 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

Neni 33. Rastet e Kompensuara

- 33.1 Rastet e kompensuara për të cilat vonesa justifikohet do të konsiderohen si vijojnë:
- a) Mbikqyrësi i Punimeve urdhëron shtyrjen ose nuk jep skicat (vizatimet) specifikkimet ose udhëzimet e nevojshme për kryerjen e punimeve në kohën e caktuar.
 - b) Mbikqyrësi i Punimeve udhëzon Kontraktorin për të zbuluar punimet e fshehta ose për të kryer provat pas kryerjes së punimeve.
 - c) Autoritet Publikë ose Autoriteti Kontraktor shkaktojnë vonesa në lirin e sheshit të ndërtimit për Kontraktorin.
 - d) Autoriteti Kontraktor vonon pa arsye lëshimin e certifikatës së marrjes në dorëzim.
- 33.2 Kompensimi i rasteve të sipërpërmendura do të bëhet si vijon:

Për vonesat e përmendura në pikat 33.1 (a,b,c,d) Autoriteti Kontraktor do të njohë shtyrjen e datës së përfundimit të punimeve mbi atë të parashikuar në këtë kontratë.

Neni 34 Taksat

- 34.1 Kontraktori është i detyruar të paguajë të gjitha taksat në përputhje me Legjislacionin Shqiptar. Për taksat e përcaktuara në legjislacionin që ka hyrë në fuqi 28 ditë para datës së hapjes së tenderit, të cilat Kontraktori⁴ duhet ti ketë marrë parasysh në vlerën e kontratës, Autoriteti Kontraktor nuk do ti njohë asnjë shtesë pagese.

- 34.2 Nëse Kontraktori nuk është i regjistruar si subjekt që ushtron aktivitet në gytetin e Tiranës është i detyruar të shlyejë ato taksa dhe tarifa vendore që kanë të bëjnë me realizimin e aktivitetit të përkohshëm në gytetin e Tiranës.

Neni 35 Dëshmipërblimi për Vonesat

- 35.1 Kontraktori do të paguaj Investitorit dëshmipërblimin për vonesa në afatin e përfundimit të punimeve në masën 2/1000 në ditë të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga

cmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

- 35.2 Sasia e përgjithshme e dëmeve të llikujtuara nuk do të tejkalojë 25% të vlerës së Kontratës. Autoriteti Kontraktor do të zbrisë dëmshtëpërblimin për vonesat nga pagesa e fundit e Kontraktor.

Neni 36 Garancia e Difekteve

- 36.1 Garancia e difekteve do të jetë 5% e vlerës së kontratës që do të mbahet nga çdo situacion Kontraktorit si garanci për cilësimin e punimeve, shumë e cila do të paguhet mbas përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve, duke marrë parasysh edhe sanksionet e parashikuara në këtë kontratë.

Neni 37 Kostoja e Riparimeve

- 37.1 Dëmtimi i punimeve ose humbja e materialeve që do të përdoren për punimet nga dita e fillimit deri në marrjen në dorëzim si dhe gjatë afatit të garancisë së difekteve do të mbulohet nga Kontraktori me shpenzimet e tij nëqoftëse humbja ose dëmtimi janë shkaktuar nga gabimet e veprimeve të tij.

- 37.2 Riparimet që dalin të nevojshme gjatë kolaudimit të veprës, nëse janë për shkak të mosplotësimit të kontratës ose të punës jo cilësore të Kontraktor do të mbuloohen nga ky i fundit me shpenzimet e tij.

Neni 38 Marrja në Dorëzim e Punimeve

- 38.1 Kontraktori pas përfundimit të Punimeve njofton me shkrim Mbikqyrësin e Punimeve dhe Investitorin. Në se Mbikqyrësi nuk ka vërejtje ky njoftim shënon datën e përfundimit të punimeve. Kontraktori pas njoftimit të përfundimit të punimeve i paraget brenda 30 ditëve Mbikqyrësit të Punimeve dokumentacionin dhe llogaritjet përfundimtare për punimet e kryera. Mbikqyrësi i Punimeve mbas verifikimeve brenda 30 ditëve së bashku me relacionin e tij i'a paraget gjithë dokumentacionin Investitorit.

- 38.2 Kontraktori duhet t'i kërkojë Mbikqyrësit të punimeve t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe mbikqyrësi i punimeve do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.

- 38.3 Nëse mbikqyrësi i punimeve zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, mbikqyrësi i punimeve do t'i japi udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerrat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.

- 38.4 Nëse mbikqyrësi i punimeve zbulon defekte në Punime, mbikqyrësi i punimeve duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

- 38.5 Mbas marrjes së gjithë dokumentacionit Autoriteti Kontraktor i paraget komisionit të kolaudimit gjithë dokumentacionin e realizimit të objektit. Me përfundimin e procedurave

të kolaudimit Autoriteti Kontraktor lëshon certifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera dhe do të çlirojë garancinë e sigurimit të Kontratës. Nga data e akt-kolaudimit të punimeve fillon periudha e garancisë së punimeve.

- 38.6 Në fund të periudhës së garancisë së punimeve, Mbikqyrësi i Punimeve dhe komisioni i marrjes në dorëzim të objektit do të përplijojnë së bashku me Autoritetin Kontraktor aktin e marrjes në dorëzim të veprës, objekt i kësaj kontrate.

Neni 39 Zgjidhja e Kontratës

- 39.1 Autoriteti Kontraktor ose Kontraktori mund të pezullojë kontratën kur vëren shkelje themelore të saj.

- 39.2 Shkeljet themelore të kontratës përfshijnë por nuk kufizohen në sa vijon:

- a) Kontraktori nuk fillon punë brenda 5 ditëve nga fillimi i zbatimit të kontratës si dhe në rastet kur ndalohen punimet me shumë së 10 ditë kur nuk parashikohet në programin e punës dhe ndalimi i punimeve nuk është i autorizuar nga Mbikqyrësi i Punimeve dhe nuk respektohet grafiku i punimeve.
- b) Mbikqyrësi i Punimeve udhëzon pezullimin e punimeve duke njoftuar Autoritetin Kontraktor dhe Kontraktorin.
- c) Kontraktori falimenton ose fillon likuidimin për arsye të tjera përveç rindërtimit ose bashkimit të shoqërisë.
- d) Kontraktori vonon kryerjen e punimeve dhe nuk realizon korrigjimet e difekteve të propozuara nga Mbikqyrësi i Punimeve.
- e) Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën për shkak të Interesit Publik, në cdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për ti shërbyer më mirë interesit publik.

Neni 40 Paguesa pas Zgjidhjes së Kontratës

- 40.1 Në rast se kontrata prishet nga Autoriteti Kontraktor për arsye objektive, Mbikqyrësi i Punimeve do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së kryer duke zbritur pagesat e marra deri në ditën e lëshimit të certifikatës.

Neni 41 Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

- 41.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori do të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrveshje që do t'u lindë gjatë realizimit të kësaj kontratë.

- 41.2 Në rast se palët nuk bien dakort atëherë për sqarimin e mosmarrveshjeve ngrihet një grup i përbërë nga tre ekspertë ku secila palë ka paraqitur një ekspert kurse i tretë pranohet nga të dy palët. Në rast se problemi nuk zgjidhet nga grupi i ekspertëve atëherë palët do t'i drejtohen Gjykatës Tiranë.

Neni 42 Legjislacioni Bazë

- 42.1 Ligji i aplikueshëm do të jetë Legjislacioni Shqiptar.

Neni 43 Sigurimi i Kontratës

43.1 Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit për fitimin e kontratës, kontraktori duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën dhe dhuratë dhe konkretisht në shumën: 15.229.745 (pese mbledhjetë milion e dyqind e njëzete e nente mijë e shtatëqind e dyzete e pese) leke e pranueshme siç specifikohet në kontratë. Dështimi për të dhene sigurimin e kontratës në formën dhe në shumën e kërkuar brenda 30 ditëve do të rezultojë në anulimin e kontratës dhe humbjen e sigurimit të Ofertës të kontraktorit.

43.2 Shuma e sigurimit të kontratës duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktorit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

43.3 Sigurimi i kontratës do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbytjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

Neni 44 Informacioni Konfidencial

44.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

Neni 45 Komunikimi

45.1 Cdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

45.2 Cdo njoftim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

45.3 Cdo miratim i dhënë duhet të bëhet me shkrim.

45.4 Komunikimi midis palëve duhet të bëhet vetëm me shkrim në adresat e deklaruara nga palët, në rast se ka ndryshim të adresës palët janë të detyruara të informojnë për çdo ndryshim. Njoftimi bëhet efektiv vetëm pasi të dorëzohet.

Neni 46: Lajmërimet

46.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

46.2 Njoftimi do të ketë efekt sapa të dorëzohet.

Neni 47. Përfaqësimi i Palëve

47.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukturë organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

47.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marrë përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të njaftueshëm.

47.3 Palët mund të emërojnë persona ose strukturë organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtyrjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 48. Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

48.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullorë, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Neni 49. Dispozita të Fundit

49.1 Kjo kontratë do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga të dy palët. Te gjitha referencat e ditëve do të jene kalendarike. Kjo kontratë u hartua në 6 (gjashtë) kopje, katër nga të cilat i mban Autoriteti Kontraktor dhe dy kopje i mban Kontraktori.



KONTRAKTORI
"AURORA KONSTRUKSION" SHPK

PËRFAQËSUESI/LIGJOR

ASTRIT HAXHIU

"EVEREST" SHPK


AUTORITETI KONTRAKTOR

BASHKIA E TIRANES

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ADMINISTRATORI I PËRGJITHSHËM

ETION KAPEDANI



PËRFAQËSUESI LIGJOR

SOKOL ÇUPI

Sokol Çupi

"BE-IS" SHPK

PËRFAQËSUESI LIGJOR

HAMZISLAMAJ



ETION KAPEDANI me pasati
Hamzi
Tuneli